

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Procesverbal – tipi i kontratës - Mallra

për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë 02.09. 2024, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhërin e prokurimit nr. 8308 Prot., datë 28.08.2024, (Nr.U 652 dt.28.08.2024) të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qera e mjeteve të transportit 2024-2026”

Numri i referencës së procedurës: REF – 17664-09-02- 2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45520000-8

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fondi limit: **32,036,972** (tridhjetë e dy milion e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, ose **320,979.58** treqind e njëzet mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë e pesëdhjetë tetë) euro pa tvsh.

* Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 02.09.2024 është **99.81** lekë/euro

vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë, me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, Nr.125, datë 22.12.2023 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për Vitin 2024 – 2026.

Argumentimi:

Grupi i punës për përcaktimin e fondit limit, i ngritur me anë të urdhrorit të brendshëm nga titullari i AK, me Nr. 4413 Prot., datë 26.04.2024 ka perlllogaritur vlerën e fondit të nevojshëm për këtë objekt prokurimi, mbështetur në mesataren e ofertave të marra nga testimi i tregut.

Nga sa më sipër ka hartuar procesverbalin mbi vendosjen e fondit limit për procedurë me objekt Nr. 4413/2 Prot., datë 20.05.2024 .

Procedurë e rishpallur: PO

Numri i referencës së procedurës së anuluar të prokurimit: REF -10467-06-21-2024.

Ndarja ne LOTE: JO

Në bazë të Paragrafit 2, Pika 1, nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Njesia e prokurimit pranë autoriteti/enti kontraktor Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Autoriteti kontraktor ka vendosur te zhvilloje kete procedure pa ndare ne lote per shkak se synon te perftoje sherbimin ne nje kohe sa me te shpejt te mundshme, pa vonesa me qellim garantimin e mbarevajtjes se punes dhe plotesimit te kerkesave ligjore te fushes mbi inspektimin në gjithë territorin e qytetit të Tiranës dhe rrethinave të tij.

Duke qene se kemi te bejme me nje sherbim me shtrirje te gjere teritoriale, autoriteti kerkon te finalizojë nenshkrimin e nje kontrate me nje operator, cka do te sillte edhe menaxhimin sa me te thjeshte dhe me te shpejte te kontrates dhe rrjedhimisht edhe perftimin e sherbimit brenda afateve te kerkuara, pa vonesa dhe pa burokraci.

Mbështetur në natyrën e njëjtë të mallit objekt porokurimi, nëse do të ndahej në lote do të ketë më shumë kontrata dhe kontraktorë të ndryshëm për të menaxhuar shumë problematika në koordinimin e dokumentacionit te mjeteve transportit shërbimeve peridike të tyre apo në rast aksidentesh.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, vendosi të mos e ndajë në lote këtë procedurë prokurimi, pasi nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura më shumë. Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara ne DST janë gjithëpërfshirëse, termat e referencës janë hartuar në mënyrë të tillë që tu jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë** (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE/ TERMA REFERENCE , SASIA DHE AFATI

Argumentimi ligjor:

Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar/perciell prane sektorit Te prokurimeve nga Grupi i punës për hartimin e Specifikimeve teknike dhe fondit limit i ngritur me urdhër të titullarit me Nr. 4413Prot., datë 26.04.2024, për procedurën e prokurimit: “Marrje me qera e mjeteve të transportit” bazuar në nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

1. Mënyra e financimit të investimit me blerje ka kosto të lartë financimi në fillim të periudhës. Në rast blerje, Mjetet kemi detyrimin ti mbajmë 10 vjet, kohë e cila kërkon shpenzime materiale për mirëmbajtje dhe procedura administrative gjithashtu. Përvoja jonë ka treguar se këtyre mjeteve nuk u janë bërë shërbimet e duhura parandaluese dhe teknike, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e tyre dhe në garancinë e përdoruesve. Le të shtojmë këtu shpenzime pa fund të nxjerrjes së tyre jashtë përdorimit. Nga përvoja shpenzimet administrative dhe të spostimit e parkimit janë shumë më të larta se ato të fitimit të skrapit të shitur.

2. Mënyra e financimit Leasing operacional konsiderohet modeli me efektiv i përdorimit të flotave të makinave për qëllime pune në institucione dhe që shfrytëzohen me kapacitet të plotë.

- *Përhapja e këtij modeli lidhet me avantazhet financiare dhe operative në krahasim me modelet e tjera të blerjes me para në dorë ose të blerjes me anë të kredive nga institucionet financiare.*
- *Këto avantazhe janë të provuara në kohë. Perfeksionimi i industrisë së leasing operacional po i bën këto avantazhe akoma më të dukshme jo vetëm në organizatat jopublike, por edhe në ato publike.*
- *Kompletimi me leasing operacional do të thote dhënie të mjetit duke paguar këstin mujor të qerasë tek qeradhënësi. Pronari i mjetit mbetet qeradhënësi. Shërbimet si: kostot e sigurimit të mjetit, të mirëmbajtjes, taksat rrugore, etj, janë detyrime të qiradhënësit.*
- *Në këtë kuadër, rekomandojmë praktikën e kompletimit të IMT Bashkisë Tiranë me mjete rrugore nëpërmjet marrjes me qera operationale (Leasing), sepse:*
 - *1. Menaxhimi i flotës është një detyrë komplekse;*
 - *2. Është më e lehtë dhe më ekonomike për institucionin që t'ja besojnë profesionistëve këtë flotë automjesh;*
- *Referuar eksperiencave të mëparshme lidhur me rifreskimin e inventarit të mjeteve të Bashkisë së Tiranës (Referuar për arsye se IMT është një institucion në varësi të saj) nëpërmjet blerjes me fonde të buxhetit të shtetit apo dhuratë nga donatorë të ndryshëm, ka rezultuar se nga përdorimi i mjeteve të llojit elektrike kemi një minimizim të shpenzimeve përsa i përket karburantit për këtë tip automjeti, duke marrë në konsideratë se kosto e vetme për këto tip automjesh "autovetura elektrike" është shpenzimi i energjisë elektrike për karikimin e baterisë së mjeteve.*

Avantazhet

- *Avantazhet e automjeteve elektrike kanë tendencën të jenë konsiderueshëm më të mëdha se disavantazhet në shumë skenarë, falë natyrës së tyre eficiente, sigurisë së shkëlqyer, mungesës së gazrave ndotës dhe benefiteve të tjera, të tilla si:*

- *Janë më të lira në operim: Me performimin e llogarive me minimale, një automjet elektrik i kursen një shoferi që përshkon 25,000 kilometra/ vit mesatarisht rreth 1000 Euro.*
- *Janë ekonomike në aspektin e harxhimit të karburantit, të shpenzimeve të mirëmbajtjes (kontrolli periodik vaj filtra, ndërrim baterie, pjesë këmbimi goma etj), të shpenzimeve për siguracionin e mjetit, shpenzimeve për kontrollin teknik të automjeteve.*
- *Karikimi: Një avantazh edhe më i mirëmenduar i automjetit elektrik është aftësia për t'i karikuar nëpër vendparkim-e. Gjithashtu po bëhet gjithnjë dhe më i mundur karikimi në një stacion-karikimi i makinave elektrike. Mjetet e flotave që karikohen nga sisteme inteligjente karikimi, ofrojnë kursime maksimale shpenzimesh, falë edhe metodave të avancuara të menaxhimit.*
- *Nuk ka zhurmë motorri: Ndotja akustike është e dëmshme për shëndetin publik dhe motorrët me djegie të brendshme të automjeteve që fuqizohen nga benzinë/ naftë, janë nga burimet me faktorë të saj.*
- *Janë të shpejta: sepse automjetet elektrike ofrojnë proporcion superior fuqi-peshë krahasuar me makinat tradicionale.*
- *Janë më të sigurt: Prodhuesit e mjeteve elektrike nuk kursejnë asnjë shpenzim në ndërtimin e sistemeve të sigurisë, që është dhe arsyeja pse i kalojnë rregullisht standartet e sigurisë.*
- *Janë më të thjeshta për t'u mirëmbajtur: Të gjitha makinat e reja me motorrë me djegie të brendshme kanë një listë të gjatë kosto mirëmbajtjeje, të cilat rrisin shumë shpejt koston totale të mjetit. Mjetet elektrike rezultojnë me kërkesa me më pak kosto mirëmbajtjeje dhe prandaj koston e mirëmbajtjes janë shumë më të pakta, pasi motorri elektrik ka një pjesë të lëvizsshme.*
- *Gjithashtu, kontrolluesi dhe karikuesi janë pajisje elektronike pa pjesë të lëvizsshme dhe kërkojnë pak ose aspak mirëmbajtje për autoveturë me 4+1 vende, elektrike.*
- *Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, duke qënë një institucion veprimtaria e të cilit konsiston kryesisht në monitorimin e terrenit dhe konkretisht në inspektimin e qytetit të Tiranës, mbi ligjshmërinë e ndërtimeve ekzistuese dhe/ ose në proces, ka të domosdoshëm përdorimin e automjeteve nga ana e punonjësve në detyrë, mbështetur në rregulloren e brendshme, organigramën e institucionit dhe zonave të inspektimit.*
- *Nevojat për 5 automjete me karburant (Gazoil) lindin për arsye të përdorimit të tyre në rrethinat e Tiranës për arsye të mungesës së infrastrukturës dhe veshitësive në karikim të mjeteve elektrike në ato zona.*
- *Duke mbajtur në konsideratë shtrirjen gjeografike të Qytetit të Tiranës dhe rrethinave të saj, volumit të punës së një institucioni të një rëndësie të veçantë si Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, mungesës së mjeteve për mbulimin e disa prej zonave, lind nevoja për automjete të cilat do të përdoren për mbarëvajtjen e punës, ushtrimin e juridiksionit të institucionit në gjithë shtrirjen gjeografike të qytetit.*

- Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK Bashkia Tiranë, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për mjete rrugore që kanë strukturat e IMT Bashkisë Tiranë, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e shërbimit.
- Mënyra e financimit të investimit me blerje ka kosto të lartë financimi në fillim të periudhës. Për arritjen e këtij objektivi një nga drejtimet kryesore është programimi dhe planifikimi me real i nevojave për mjete levizëse, si dhe krijimi i burimeve të reja në përputhje me kërkesat për këtë shërbim nga strukturat përgjegjëse.
- Specifikimet teknike
- Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

1. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MAKINAT ELEKTRIKE (SASIA 5 COPE):

Kërkesat teknike për autoveturë elektrike 4+1 vende:

Viti i Prodhimit	Min 2021
Kilometrazhi	0 km
Motorri	Elektrik
Fuqia Totale	Min 100 Kw (134PS)
Kambio	Automatike
Tërheqja	2 X 4
Konsumi i Kombinuar 100 km	Max 17k wh
Emetimi i Gazrave CO2	0 g/Km
Përmasat e makinës:	
Gjatësia	Jo më pak se 3.600 mm
Gjërësia pa pasqyra	Jo më pak se 1.600 mm
Lartësia	Jo më pak se 1.400 mm
Distanca aksiale	Jo më pak se 2.400 mm
Kabina:	
Numri i dyerve	4 + 1
Numri i vendeve	4 + 1
Tipi i baterisë	Lithium-ion
Kapaciteti Nominal I Baterisë	Jo më pak se 55 Kwh
Kohëzgjatja e karikimit I plote prizë normale 0-100%	Jo më shumë se 8 ore
Pesha boshe e makinës	Jo më pak se 1600 kg
Shpejtësia Maksimale	Jo më pak se 130 km/h
Distanca maksimale me një karikim	Jo më pak se 400 Km
Lënda djegëse	Energji Elektrike
Aksesorë shtesë:	

Airbag min 6 cope	
ABS+ ESC+ HAC	
Kontroll Automatik i Dritareve	
Mbyllje qendrore me pult	
Xhamat elektrike	
Dritat elektrike	
Dritat Led	
Ndezje makinës pa çelës	
Timon Multifunksional	
Bluetooth	
Kontroll shpejtësie (Cruise Control)	
Klimatronik	
Sensor parkimi	
Sistem Kamera(mbrapa)	
Radio me AUX + USB	

* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkuorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operacionale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Ruajtje e imazhit profesional

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 30 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim IMT Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qera operacionale të një sasive mjetesh rrugore.

MËNYRA E OPERIMIT:

- 1) Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- 2) Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).
- 3) Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- 4) Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me energji elektrike i baterisë së mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.
- 5) I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operacionale.

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:

A. Kërkesa të përgjithshme

- a. Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);
- b. Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje;
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkuorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat do të logohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

B. Kërkesa të veçanta

- a. Dizajnimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- b. Mjetet të jenë të pajisura me konsole karikimi CCS (combined charging system)
- c. Mjetet të jenë të pajisura me kabull për karikim publik në AC, si dhe kabull rrjeti për karikim në kushte të tjera;
- d. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

2. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR AUTOVETURË ME NAFTE (SASIA 5 COPE):

Kërkesat teknike

Kilometra të përshkruara 0 km

Viti i prodhimit: Min 2021

Tërheqja: 2x4 ose 4x4

Numri i vendeve: 4+1 (Katër plus një)

Dyer: 4-5

Motorri: Jo më tepër se 2500 CC

Lloji i Karburantit: Naftë

Kategoria Ambientale: Euro 6

Fuqia: Jo më pak se 145 KF

Kutia e shpejtësisë: Kambio manual ose automatike

Kapaciteti mbajtës: min 200 KG

Dimensionet e Përgjithshme a- Gjatësia: Jo më pak se 4000 mm

Lartësia: Jo më pak se 1600 mm

Gjerësia (pa pasqyra): Jo më pak se 1800 mm

Distanca aksiale: Jo më pak se 2500 mm

Konsumi urban: Jo më shumë se 15L/ 100Km

Konsumi inter- urban: jo më shumë se 8L/ 100Km

Konsumi i kombinuar: Jo më shumë se 10L/ 100Km

* Në respektim të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operacionale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Ruajtje e imazhit profesional

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë tre vjeçare, (0 deri në 3 vjet), pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për tre vjet me një planifikim vjetor jo më pak se 30 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim IMT Bashkia Tiranë ka planifikuar marrjen me qera operacionale të një sasive mjeteve rrugore.

MËNYRA E OPERIMIT:

- a. Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- b. Kompania ofron makinat e kërkuara në një kontratë 3 vjeçare (36 muaj).
- c. Makinat nuk figurojnë si asete të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- d. Gjatë këtyre 3 vjetëve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi me karburant i mjetit dhe kryerja e aktivitetit të tij.
- e. I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operacionale.

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi dhe mbulimi me shpenzimet e tij i pagesave në lidhje me to, gjatë gjithë periudhës së kontratës**, nga kompania duhet të përfshijë:

A. Kërkesa të përgjithshme

- a. Të gjithë dokumentacionin e makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj., si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie etj);
- b. Të gjithë procesin e sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash;
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit;
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike, si dhe mbulimin me shpenzimet e tij të pagesave në lidhje me to;
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve;
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë;

- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira) në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve;
- h. Të marrë masa për zëvendësimin e automjetit deri në riparimin final në rast defekti;
- i. Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS;
- j. Makinat do të logohen sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

B. Kërkesa të veçanta

- a. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i 3 viteve të fundit
- b. Dizenjimin e mjeteve me logo sipas porosisë së përdoruesit;
- c. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës: Në ambientet e operatorit ekonomik fitues

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni
1	Autovetura elektrike	5 copë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë
2	Autovetura Naftë	5 copë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë

Afatet e lëvrimit: Afati kohor i ofrimit të mjeteve me qera, do të jetë për një periudhë kohore prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga momenti i dorëzimit të mjeteve.

Lëvrimi: Mjetet duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Specifikimet teknike minimale të kërkuara janë hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e institucionit, destinacionin ku do të përdoren mjetet, terrenin ku do të përdoren, intesitetin e punës, kostot e mirëmbajtjes, vlerën e konsiderushme të mallrave objekt prokurimi, afati i kontrates, shërbimeve minimale të nevojshme të cilat do të përfshihen në kontratë

Specifikimet e vendosura lidhen ngusht me elementët më të rëndësishëm përbërës TË automjeteve, që garantojnë cilësinë e kërkuar, sigurinë mbi shendetin dhe jetën e punonjësve të cilët do të përdorin automjetet, duke garantuar mbarvajtjen në veprimtarinë e institucionit,

Duke qënë se marrja me qera e 10 mjeteve është një investim i konsiderueshëm i Autoritetit janë kërkuar specifika të nevojshme si mësipërcituar të cilat shprehin qart nevojat e autoritetit duke mos krijuar konfuzion te operatorët ekonomik konkurues në procedurë, duke nxitur pjesmarrjen në konkurim konform legjislacionit në fuqi.

Sasia e mjeteve është vendosur në mbështetje të nevojave të institucionit dhe veprimtarisë së tij e cila konsiston në inspektimin në terren të qytetit të tiranës, mbi ligjshmërine e ndërtimeve ekzistuese dhe/ ose në proces, volumit të punës , të cilat sjellin rrjedhojën e domosdoshmerisë së mjeteve në përdorim nga ana e punonjësve në detyrë, mbështetur në organigramën e institucionit dhe zonave të inspektimit.

Afati është vendosur në mbështetje të nevojave të vazhdueshme të institucionit për këtë furnizim/shërbim si dhe në PBA e miratuar konkretisht për vitet 2024-2026.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.” si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

(Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi:

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit

limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 1, 2 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: bazuar në pikën 2 b, te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 3 te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve (2022,2023) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar Nenin 43 pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

2 **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në momentin e procedurës, e cila vërteton cilësinë e menaxhimit të cilësisë ISO 9001: 2015/ose/ ekuivalent, ku përfshihet objekti i prokurimit. Certifikata duhet të lëshohet nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organi kombëtar i akreditimit ose organe akreditimi të njohura ndërkombëtarisht, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (pikën 1/a), nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuar në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” dhe piken 6/b të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë shërbimi/ bashkëpunimi/ huapërdorje/ qiraje (të vlefshme), auto servis, me qëllim mirëmbajtjen, riparimin apo difekteve teknike të mjeteve gjatë gjithë shtrirjes të kontratës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 , pikën 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.3.5 Operatori duhet të paraqes deklarate mbi permbushjen e kushteve të specifikimeve teknike dhe termave të references dhe konkretish si parashikohen në Shtojcën 5 dhe 7 të DST.

Shënim: 1. a. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

b. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në rastet e dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi ligjor: Nenit 40, pika 6 dhe 8 , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar).dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Data e zhvillimit të kësaj procedure do të jetë Data: 08.10.2024 ora 09:00 në adresën: www.app.gov.al,

Procesverbali pasi u lexua, u firmos nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit të si më poshtë:

